




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Emri i Detyrimit Prangosa: Prangosa Task: Duty	21.01.22	2	viti viti year
Emri i Autorit Emri i Autorit Name	Prot. No. Prot. No.	Shkronja e Emri i Autorit Signature	Shkronja e Autoritetit Signature
SKPM SHCK	267/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.967/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë si dhe Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.967/2021 të datës 25.11.2021 të parashtruar nga ankuesi

me adresë: _____ ë cilin me autorizim e përfaqëson Avokati _____ të çështjen juridike

“kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 21.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e datës 22.11.2021 të parashtruar nga ankuesi

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ me datë 25.11.2021 përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar avokatit _____ ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 5674/2021 të regjistruar me numër A.nr.967/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 22.11.2021 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 02.12.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa me datë 07.12.2021 ka pranuar përgjigjen se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/22.



Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sipas kërkesës së kryetarit të Kolegjit, me datë 29.12.2021 ka nxjerr Vendimin VK.nr.69/2021 përmes të cilit është vazhduar afati për vendosje edhe për dhjetë (10) ditë pune, lidhur me ankesën A.nr.967/2021 të datës 25.11.2021 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Vendimin e datës 29.12.2021 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e ankuesit e datës 25.11.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi për përfaqësim i datës 23.11.2021 i Avokatit .

Akt emërimi i ankuesit i datës 09.10.2012; Akt emërimi i ankuesit i datës 18.01.2017; Vendimi për emërim i datës 11.06.2019; e-mail-at e datave 03.06.2021, 01.06.2021, 07.06.2021; Vendimi me numër 2111/21 i datës 03.06.2021 i Ministrit të Ministrisë së Mjedisit, Palnifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës; e-mail i datës 22.11.2021; Kërkesë për opinion ligjor i datës 21.10.2021; Gjendja e llogarisë Bankare e datës 25.11.2021; e-mail-at e datave 07.06.2021, 03.06.2021, 01.06.2021, 28.09.2021, 21.09.2021, 08.09.2021, 06.12.2021, 02.12.2021 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë konstatoi se janë plotësuar kushtet ligjore që të detyrohet organi administrativ kompetent gjegjësisht Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, që të nxjerrë akt administrativ, lidhur me kërkesën e datës 22.11.2021, të parashtruar nga ankuesi

sepse

Bazuar në provat e lëndës gjegjësisht Akt Emërimin e datës 18.01.2017 është konstatuar se ankuesi ka qenë i punësuar në vendin e punës *Drejtor i Drejtoratit të Pronave të Paluajtshme*, në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ndërsa sipas Vendimit me numër 06/106 të datës 11.06.2019 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ankuesi me datë 11.06.2019 është emëruar *Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kadastrale të Kosovës*, me mandat tre (3) vjeçar.

Ankuesi, përmes e-mailit të datës 01.06.2021 i është drejtuar Ministrit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me kërkesë për lirim të tij nga pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Ky i fundit, me datë 03.06.2021 ka nxjerr Vendimin me numër të protokollit 2111/21 me të cilin ka aprovuar kërkesën e ankuesit për përfundimin e parakohshëm të mandatit nga pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, dhe njeherit është kërkuar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, që të veprojnë konform kompetencave dhe akteve ligjore në fuqi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi me datë 03.06.2021 ka parashtruar kërkesë të Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, nga i cili ka kërkuar që t'i ndërmerret veprimet ligjore për ta sistemuar të njëjtin në pozitë të mesme drejtuese sipas Vendimit me numër protokollit 2111/21 të datës 03.06.2021 të Ministrit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, përmes e-mailit të datës 07.06.2021 e ka njoftuar ankuesin se: *"Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/DMZP duke u bazuar në Ligjin Nr.06/L-144 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, emëron nëpunësit të cilit i mbaron mandati në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale"*, mirëpo sipas



shkresave të lëndës Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, nuk ka nxjerr një akt administrativ lidhur me çështjen përkatëse.

Andaj, në mungesë të një akti administrativ, ankuesi përsëri me datë 22.11.2021 ka parashtruar kërkesë të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, për të vendosur lidhur me sistemimin e tij në një pozitë të nivelit të mesëm drejtues. Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, përmes emailit zyrtar të datës 22.11.2021 i është përgjigjur ankuesit duke njoftuar të njëjtin se ende nuk kanë mundur të marrë vendim përfundimtarë lidhur me çështjen e tij edhe pse kanë pranuar opinion ligjor nga Departamenti Ligjor në Ministrin e Punëve të Brendshme, dhe e rekomandon ankuesin për parashtrimin e ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi, ka analizuar dispozitat e nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6, nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.16 dhe nenin 42 paragrafi 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë si njësi përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore, është kompetent për emërimin e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues të cilëve ju mbaron mandati, fillimisht në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale.

Andaj, duke marr parasysh rrethanat si me lartë, Kolegji konstaton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, është i obliguar që të shqyrtoj kërkesën e datës 22.11.2021 të parashtruar nga ankuesi si dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.967/2021

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Jeton KOÇA
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit avokatit
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Menaxherit të Personelit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.